

UDHËZUES PËR PLOTËSIMIN E FORMULARIT A1

Matura Shtetërore 2013

1. **Formulari A1** plotësohet online. Procedura e plotësimit do të bëhet sipas një udhëzimi të veçantë.
2. **Formularin A1** e plotësojnë vetëm maturantët e vitit shkollor 2012 – 2013.
3. Plotësimi i **Formularit A1** fillon në Portalin Qeveritar dhe përfundon në Portalin Matura Online në shkollën që caktohet nga DAR/ZA.
4. Procesi i plotësimit **Formularit A1** ndiqet nga një person i ngarkuar nga drejtoria e shkollës, që quhet “mbikëqyrës”.
5. Mbikëqyrësi pajiset me kodin përkatës të hyrjes në sistem. Vetëm pasi mbikëqyrësi fut kodin në sistem, maturanti mund të përfundojë plotësimin e **Formularit A1**.
6. Lista me të dhënat e marra nga plotësimi i formularëve printohet, nënshkruhet nga maturanti, mbikëqyrësi dhe vulozet nga drejtori i shkollës ku plotësohen formularët A1. Listat ruhen deri në përfundim të Maturës Shtetërore 2013.

I. TË DHËNA PERSONALE

Plotësohen nga maturanti.

- **Tek pika 1**, (numri personal i letërnjoftimit ID), maturanti shënon numrin e tij personal që ka në dokumentin e identifikimit.

Për të dhënat 2-5, pasi maturanti bën plotësimin, sistemi bën verifikimin e tyre dhe nuk lejon të vazhdohet aplikimi, nëse ka pasaktësi.

- **Tek pika 6**, maturanti shënon në fushat përkatëse, numrin e telefonit dhe adresën e email-it, të cilat duhet të ruhen të pandryshuara deri në fund të Maturës Shtetërore 2013, me qëllim që ai (maturanti) të marrë informacion në faza të ndryshme të procesit. Nëse maturanti nuk ka telefon, ose nuk dëshiron të shënojë numrin e telefonit, atëherë shënon mbikëqyrësi numrin e tij të telefonit.

II. TË DHËNA SHKOLLORE

Të dhënat shkollore do të plotësohen në bashkëpunim me **mbikëqyrësin** e sallës ku bëhet aplikimi.

Për plotësimin saktë të kërkesave të këtij grupimi, maturanti dhe mbikëqyrësi duhet të marrin informacion të saktë dhe të plotë për rubrikat përkatëse:

Plotësohen nga maturanti.

- **Tek pika 7**, maturanti zgjedh nga lista “Prefekturën” që përfshin shkollën ku po studion.
- **Tek pika 8**, (emri i qytetit/fshatit), plotësohet automatikisht nga sistemi emri i qytetit/fshatit ku ndodhet shkolla ku po studion, në varësi të plotësimit të pikës 9.

- **Tek pika 9**, (emri i shkollës ku studion), maturanti zgjedh nga lista emrin e shkollës ku po studion.

Plotësohen nga mbikqyrësi.

- **Tek pika 10**, (indeksi i profilit), plotësohet automatikisht nga sistemi në varësi të zgjedhjes së pikës 11.
- **Tek pika 11**, (emërtimi i profilit) mbikqyrësi plotëson emrin e profilit/degës.

Plotësohen nga maturanti.

- **Tek pika 12**, maturanti plotëson klasën dhe paralelin e klasës ku po studion.
- **Tek pika 13**, maturanti zgjedh nga lista Po ose Jo.

III. TË DHËNA LËNDORE

Plotësohen nga maturanti.

- **Tek pika 14**, maturanti zgjedh nga lista lëndët Z1 dhe Z2 që dëshiron të japë provim.

Zgjedhja e lëndëve Z1 dhe Z2 bëhet në përputhje me Udhëzimin nr. 35, datë 27.11.2012, në të cilin theksohet:

- Numri i lëndëve që do të zgjidhen duhet të jetë detyrimisht 2 (dy).
- Shuma e krediteve të dy lëndëve që zgjidhen, duhet të jetë jo më e vogël se 8 (tetë).
- Kur zgjidhet një lëndë bërthamë, nuk mund të zgjidhet e njëjta lëndë e thelluar (përgjashtuar lëndët e detyruara).
- Çdo maturant mund të zgjedhë një ose dy gjuhë të huaja të ndryshme, me kusht që njëra do të trajtohet si gjuhë e huaj e parë dhe tjetra si gjuhë e huaj e dytë, pavarësisht nëse ka bërë ose jo në shkollë.
- Maturantët e shkollave artistike mund të zgjedhin vetëm njërën nga lëndët e grupit II: “Vetëm për shkollat artistike”.
- Maturantët e shkollave profesionale mund të zgjedhin vetëm njërën nga lëndët e grupit II: “Vetëm për shkollat profesionale”. Teoria profesionale është e zërthyer në profile sipas indeksit të shkollave dhe maturanti mund të zgjedhë vetëm një prej tyre.